



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:264207

Datë: 21.02.2022

Numri i dokumentit: 02733803

PKR.nr.191/21

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. Sh, për shkak të veprës penale, “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, PP/L.nr.226/21 të datës 26.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të hapur për publikun, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit A. Sh si dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Arben Kelmendi nga Peja, me dt.09.02.2022 merr dhe me dt.21.02.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari A Sh i lindur me datë ..... në fshatin L. Komuna P., me vendbanim në të njëjtin fshat, i biri i D nënës R , ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ....., i pa punë, invalid i gjendjes dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB Republika e Kosovës ,me numër personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Më parë ka siguruar e gjer me datë 29.06.2021,rreth orës 07:30 minuta, në shtëpinë e tij në fshatin L, Komuna P., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ,mban në pronësi armë në atë mënyrë, që pas incidenti me disa banorë të fshatit që kishte ndodhur rreth vendosjes së vijës kadastrale të pronës së të dyshuarit me rrugën e fshatit, policia kishte proceduar disa nga pjesëmarrësit në incident, me ç ‘rast edhe kishte pranuar informacion se i dyshuari kishte në pronësi një armë, ashtu që pas procedimit nga ana e policisë, i njëjti kishte pranuar se kishte në pronësi 1( një) pistoletë ,, ...’’, kalibër 7.62x25mm,me nr. serik ...., 1 (një) karikator të të njëjtës pistoletë dhe 25 ( njëzet e pesë) fishek kalibër 7.62 x 25 mm, dhe e cila është konfiskuar pasi që për të njëjtën nuk posedonte leje përkatëse,

-Me çka ka kryer veprë penale, “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 4, 7,17,38,46,47,48,49,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së ,të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që të akuzuarit A. Sh, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 ( një) viti nuk kryen veprë të re penale.

I akuzuari, lirohet nga pagimi i shpenzimeve procedurale dhe të njëjtat i bien në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

Të akuzuarit i konfiskohet1( një) pistoletë „ ..’’, kalibër 7.62x25mm,me nr. serik ..., 1 (një) karikator të të njëjtës pistoletë dhe 25 ( njëzet e pesë) fishek kalibër 7.62 x 25 mm, të cilat gjenden në Zingjirin e Ruajtjes në DRP Stacioni Policor sipas numrit të rastit ...-...-.... dt.19.06.2021.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.226/21 me datë 26.11.2021, ndaj të akuzuarit A. Sh nga fshati L K P., për shkak të veprës penale, “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 09.02.2022. Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/I.nr.226/2021, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën pranimin ose mos pranimin e fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari, ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroi se e pranon fajësinë për veprë penale e cila i vihet në barrë.

Prokurorja e shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse në çdo fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë duke i propozuar gjykatës, që me rastin e vendimit mbi dënimin të merren si rrethana lehtësuese pranimin i fajësisë, kushtet shumë të vështira ekonomike pendimi nga ana e tij për veprën e kryer penale ,ndërsa sa i përket armës prokurorja i propozoj gjykatës që e njëjta të konfiskohet meqenëse është objekt i veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Arben Kelmendi, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe kërkon nga Gjykata që të mbrojturit të tij të i shqiptohet një dënim më i butë mundësisht dënim me kusht pasi që i njëjti nuk ka mundësi financiare të paguaj dënim me gjobë, për shkak të kushteve të vështira ekonomike po ashtu ka kërkuar të lirohet edhe nga pagesa e

shpenzimeve procedurale duke shtuar se është shfrytëzues i pensionit invalidorë dhe i njëjti nuk është i aftë për punë.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe ka mbështetje në shkresat që gjenden në shkresa të lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raportet e policit A.SH #.. të përpiluara nën numër të rastit ...-...-... dt.29.09.2021, deklarata e dëshmitares C. G e dhënë në vendngjarje me dt.29.06.2021, lista e armës së konfiskuar nga i dyshuari i rastit e përpiluar sipas nr. të rastit ...-...-... dt.29.06.2021, fotografi nga vendi i ngjarjes dhe fotografitë të mjetit të gjetur dhe të konfiskuar, lista e dëshmimeve e përpiluar sipas numrit të rastit ...-...-... dt.29.06.2021, deklarata e të dyshuarit A. Sh e dhënë pranë Stacionit Policor në P-Njësi të Hetimeve dt.29.06.2021 dhe deklarata e të pandehurit A. Sh e dhënë në prokurori me datë 24.11.2021 si dhe nga administrimi i shkresave tjera të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e i akuzuari ka pranuar fajësinë, pendimin e tij për veprën e kryer penale, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e vështirë ekonomike se me familje jeton nga të ardhurat që i realizon nga pensioni invalidor dhe benificionet e personave me aftësi të kufizuar ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRRPK-së.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së konfiskohen arma dhe municioni të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPPRK-së, Gjukata ka vendosur që të pandehurin ta liroi nga pagimi i shpenzimeve procedurale dhe të paushallit gjyqësor, nga se i njëjti është shfrytëzues i pensionit si invalid me aftësi të kufizuar dhe pagimi i këtyre shpenzimeve do ta vështirësonte gjendjen materiale të tij.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2021:264207, 21.02.2022**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.